



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Nr. 1955 prot.

Tiranë më, 18.12.2023

**V E N D I M**

**Nr. 8, datë 13.12.2023**

**PËR**

**“MIRATIMIN PARAPRAK TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË  
BASENIT UJOR MAT 2024-2029”**

Në mbështetje të shkronjës “d”, pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, të Kreut 3, të Shtojcës II, të Vendimit nr.1015, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmytjet”, paragrafit “vii”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut III, të vendimit nr.221, datë 26.4.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit

**V E N D O S I:**

1. Miratimin Paraprak të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Mat, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.
2. Zbatimi i Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Mat fillon në vitin 2024.
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për ndjekjen e procedurës për miratimin e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Mat në Këshillin e Ministrave.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**BELINDA BALÇUKU**



**AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**GERTA LLIBONJA**

